REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2026

"PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË SHTETËRORE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA PËR FURNIZIMIN E INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR ME PRODUKTE MJEKËSORE PËR PËRDORIM NJERËZOR, PAJISJE MJEKËSORE DHE SHËRBIME TË TJERA MBËSHTETËSE"

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

a) garantimin e furnizimit të vazhdueshëm, të sigurt, cilësor dhe me kosto efektive të institucioneve publike të kujdesit shëndetësor, me produkte mjekësore për përdorim njerëzor, pajisje mjekësore, produkte të tjera shëndetësore, mallra dhe shërbime mbështetëse;
b) rritjen e efiçencës në përdorimin e fondeve publike, garantimin e transparencës, të konkurrencës, cilësisë së produkteve, si dhe plotësimin në kohë të nevojave të institucioneve publike të kujdesit shëndetësor;
c) krijimin dhe përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e shoqërisë shtetërore përgjegjëse për optimizimin dhe garantimin e administrimit të duhur të proceseve të planifikimit dhe prokurimit të përbashkët, furnizimit, importit, magazinimit, transportit, shpërndarjes, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të produkteve mjekësore për përdorim njerëzor, pajisjeve mjekësore dhe produkteve të tjera shëndetësore.

Neni 2
Objekti

Ky ligj rregullon krijimin, organizimin dhe funksionimin e shoqërisë "MedAL" sh.a. (në vijim "Shoqëria"), ushtrimin e funksionit të saj si organ qendror blerës dhe ofrues i shërbimeve të përbashkëta për institucionet publike të kujdesit shëndetësor, marrëdhëniet e saj me

institucionet përfituese dhe palët e treta, format e bashkëpunimit me këto institucione dhe me subjekte të tjera publike dhe/ose private, si dhe përcakton statusin, kompetencat, burimet e financimit, mënyrën e administrimit dhe të mbikëqyrjes së saj.

Neni 3

Statusi juridik

1. Shoqëria krijohet si person juridik, i organizuar në formën e shoqërisë aksionare, me kapital 100% shtetëror.
2. Autoriteti publik që përfaqëson shtetin si aksionar i Shoqërisë është ministria përgjegjëse për shëndetësinë.
3. Krijimi, organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë i nënshtrohen dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.
4. Statuti dhe akti i themelimit të Shoqërisë miratohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Shoqëria ka selinë në Tiranë dhe ka të drejtë të krijojë magazina qendrore ose struktura të tjera qendrore dhe rajonale, në zbatim të dispozitave të këtij ligji.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë

1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është plotësimi i nevojave të institucioneve publike të kujdesit shëndetësor për produkte mjekësore, pajisje mjekësore, produkte të tjera shëndetësore, si dhe mallra dhe shërbime mbështetëse, me qëllim garantimin e sigurisë së furnizimit, përdorimin efiçent dhe me kosto efektive të fondeve publike, si dhe cilësinë dhe disponueshmërinë e produkteve të furnizuara.

2. Shoqëria për realizimin e objektit të saj:

a) identifikon, vlerëson dhe planifikon në mënyrë të përbashkët nevojat e institucioneve publike të kujdesit shëndetësor për produkte mjekësore për përdorim njerëzor, pajisje mjekësore, produkte të tjera shëndetësore, mallra dhe shërbime mbështetëse;
b) harton strategjinë e blerjeve të përbashkëta dhe planet vjetore e periodike të furnizimit, bazuar në kërkesat e institucioneve përfituese, protokollet klinike, të dhënat e konsumit, nivelet e stoqeve, analizën e tregut dhe fondet e miratuara;
c) ushtron funksionin e organit qendror blerës për institucionet publike të kujdesit shëndetësor dhe organizon procedurat e blerjeve të përbashkëta, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi;
ç) zhvillon, vetë ose nëpërmjet formave të bashkëpunimit të parashikuara në këtë ligj, kapacitete prodhuese vendase për produkte mjekësore dhe pajisje mjekësore;
d) zhvillon procedura të prokurimit publik, lidh marrëveshje kuadër, ngre sisteme dinamike blerjeje dhe përdor instrumente të tjera prokurimi të lejuara nga legjislacioni në fuqi;
dh) negocion dhe blen mallra e shërbime në emër dhe për llogari të institucioneve publike të kujdesit shëndetësor, në zbatim të këtij ligji;
e) lidh, administron dhe monitoron marrëveshjet kuadër, kontratat e furnizimit dhe kontratat e tjera që lidhen me realizimin e objektit të saj;
ë) organizon dhe siguron blerjen, importin, magazinimin, transportin, shpërndarjen dhe furnizimin me produkte mjekësore, pajisje mjekësore dhe produkte të tjera shëndetësore;
f) administron dhe optimizon zinxhirin e furnizimit, logjistikën e brendshme, magazinimin,

inventarin, transportin, shpërndarjen dhe pagesat;

g) monitoron performancën e furnizuesve, cilësinë dhe sigurinë e produkteve, afatet e furnizimit dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktuale;

gj) harton katalogë të përbashkët të produkteve, në bashkëpunim me institucionet përfituese dhe në përputhje me politikat e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;

h) krijon dhe administron stokun e produkteve mjekësore, pajisjeve mjekësore dhe produkteve të tjera shëndetësore kritike, në përputhje me politikat e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;

i) harton dhe zbaton masa për parandalimin dhe menaxhimin e mungesave të produkteve mjekësore, për reagimin ndaj emergjencave shëndetësore dhe për përballimin e ndërprerjeve të zinxhirit të furnizimit;

j) negocion, administron dhe monitoron marrëveshje të veçanta të hyrjes së menaxhuar për produktet mjekësore, kur autorizohet nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi;

k) krijon dhe administron platforma dhe sisteme elektronike për planifikimin, prokurimin, administrimin e kontratave, menaxhimin e inventarit, gjurmueshmërinë, monitorimin e stoqeve dhe shpërndarjen;

l) mbledh, përpunon dhe analizon të dhëna për konsumin, stoqet, kostot, performancën e furnizimit dhe treguesit e efiçencës, si dhe harton raportet përkatëse për këto të dhëna;

ll) u ofron asistencë teknike dhe profesionale institucioneve publike të kujdesit shëndetësor për planifikimin e duhur të nevojave të tyre;

m) lidh kontrata dhe marrëveshje bashkëpunimi me autoritete publike, institucione shëndetësore, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, institucione financiare dhe subjekte private, për realizimin e objektit të saj;

n) krijon shoqëri të tjera ose merr pjesë në kapitalin e shoqërive të tjera, publike ose private, që kanë si objekt prodhimin dhe/ose tregtimin e produkteve mjekësore për përdorim njerëzor, pajisjeve mjekësore dhe produkteve të tjera shëndetësore, si dhe kryerjen e veprimtarive që lidhen me to, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji;

nj) financon ose bashkëfinancon projekte në fushën e shëndetit publik;

o) tregton, vetë ose nëpërmjet subjekteve të tjera të krijuara prej saj ose në bashkëpunim me subjekte private, produkte të prodhuara në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Këshilli i Ministrave mund ta autorizojë Shoqërinë të kryejë funksione të tjera që lidhen me veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Shoqëria mund t'i ofrojë veprimtaritë e përcaktuara në këtë nen për:

a) institucionet publike të kujdesit shëndetësor dhe institucione të tjera të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë;

b) institucione të tjera publike që veprojnë në fushën e shëndetësisë;

c) institucionet private të kujdesit shëndetësor, në bazë të kontratave të lidhura me to, me kusht që kjo veprimtari të mos cenojë përmbushjen e funksionit publik të Shoqërisë dhe furnizimin e institucioneve publike të kujdesit shëndetësor.

Neni 5

Burimet financiare

1. Burimet e financimit të Shoqërisë janë:

   a) buxheti i shtetit, për financimin e kapitalit, në zbatim të nenit 3 të këtij ligji;

   b) të ardhurat e krijuara nga ushtrimi i veprimtarisë së saj për ofrimin e shërbimeve për subjektet publike dhe private, sipas tarifave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

   c) donacionet, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

   ç) burime të tjera të lejuara nga legjislacioni në fuqi.

2. Detyrimet financiare të Shoqërisë nuk kalojnë në buxhetin e shtetit. Përgjegjësia për shlyerjen e detyrimeve financiare i takon Shoqërisë.

Neni 6

Bashkëpunimi me palët e treta dhe pjesëmarrja në shoqëri të tjera

1. Për realizimin e objektit të saj, Shoqëria ka të drejtë të hyjë në marrëdhënie juridike dhe tregtare me persona juridikë publikë ose privatë, vendas ose të huaj, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi.

2. Shoqëria, me nismën e saj ose me kërkesë të palëve të treta, bashkëpunon me subjekte private, nëpërmjet pjesëmarrjes në një bashkim operatorësh ekonomikë, në partneritet publik-privat sipas legjislacionit në fuqi dhe/ose nëpërmjet formave të ndryshme kontraktuale të lejuara nga legjislacioni civil dhe tregtar.

3. Shoqëria krijon shoqëri të tjera ose merr pjesë në kapitalin e shoqërive të tjera publike ose private, vendase ose të huaja, objekti i të cilave përfshin një ose disa nga veprimtaritë e mëposhtme:

   a) prodhimin dhe/ose tregtimin e produkteve mjekësore për përdorim njerëzor, pajisjeve mjekësore dhe produkteve të tjera shëndetësore;
   b) importin, eksportin, magazinimin, transportin dhe shpërndarjen e këtyre produkteve;
   c) zhvillimin, transferimin dhe përdorimin e teknologjisë, sistemeve, platformave dhe pajisjeve në sektorin e shëndetësisë;
   d) veprimtari të tjera prodhuese, tregtare, teknologjike ose logjistike që lidhen me fushën e saj të veprimtarisë.

4. Kushtet e negocimit të Shoqërisë me subjektet private miratohen rast pas rasti me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Shoqërisë, të paraqitur nëpërmjet ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Pas miratimit të kushteve të negocimit, Shoqëria vijon procedurat sipas pikave 5 dhe 6 të këtij neni.

5. Kur Shoqëria synon të bashkëpunojë me subjekte private, procedurat përzgjedhëse janë procedura konkurruese, që zhvillohen nga Shoqëria në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit, efiçencës, mbrojtjes së informacionit konfidencial, fizibilitetit ekonomik dhe tregtar të projekteve, trajtimit të barabartë, reciprocitetit dhe sigurisë juridike, si dhe në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e brendshme rregullatore të Shoqërisë.

6. Kur Shoqërisë i paraqiten kërkesa për bashkëpunim nga palë të treta shtetërore ose private, Këshilli Mbikëqyrës autorizon Administratorin të ngrejë një grup negocimi të ofertës, i cili është përgjegjës për vlerësimin dhe negocimin e kërkesës së paraqitur, në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Shoqërisë dhe me objektivat e përcaktuara në këtë ligj. Raporti i grupit të negocimit i paraqitet Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë, i cili miraton ose refuzon bashkëpunimin e propozuar në rastin konkret.

7. Shoqëria garanton në çdo rast, në përputhje me ligjin dhe me kërkesat e palëve konkurruese, konfidencialitetin e informacionit të administruar prej saj dhe të klasifikuar gjatë procedurave si sekret shtetëror, tregtar ose industrial. Dokumentet e administruara nga Shoqëria gjatë këtyre procedurave nuk bëhen publike kur kjo bie ndesh me interesin publik ose me interesat e sistemit shëndetësor.

8. Gjatë përzgjedhjes së subjektit privat me të cilin do të bashkëpunojë Shoqëria siguron, sipas rastit, që:

   a) subjekti të plotësojë kriteret e nevojshme për ushtrimin e veprimtarive në fushën e furnizimit me produkte mjekësore për përdorim njerëzor, pajisje mjekësore, produkte të tjera shëndetësore dhe mallra e shërbime të tjera mbështetëse, përfshirë licencat dhe kapacitetin ligjor, teknik, operacional dhe financiar;

   b) subjekti të garantojë respektimin e standardeve të cilësisë, sigurisë dhe gjurmueshmërisë që zbatohen për produktet mjekësore për përdorim njerëzor, pajisjet mjekësore dhe produkte të tjera shëndetësore në të gjitha fazat e prodhimit, furnizimit, tregtimit, magazinimit, transportit dhe shpërndarjes, sipas objektit të bashkëpunimit;

   c) subjekti të garantojë raportimin e veprimtarive të tij në përputhje me standardet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare;

   ç) subjekti të garantojë respektimin e konfidencialitetit të të dhënave që lidhen me veprimtarinë e Shoqërisë;

   d) subjekti të plotësojë kriteret e besueshmërisë, integritetit dhe reputacionit në fushën e tij të veprimtarisë.

9. Shoqëria për mbrojtjen e interesave të saj, pavarësisht nga kuotat e pjesëmarrjes së saj në këto subjekte, ushtron të drejtën e vetos për çështjet e mëposhtme:

   a) ndryshimin e statutit;

   b) rritjen ose zvogëlimin e kapitalit;

   c) shpërndarjen e fitimit;

   ç) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

   d) pranimin e aksionarëve të tjerë.

10. Shoqëria është e detyruar të garantojë respektimin e kërkesave ligjore, të parandalojë abuzimet e mundshme në furnizimin me produkte mjekësore për përdorim njerëzor dhe pajisje mjekësore dhe të ndalojë konkurrencën e paligjshme, duke ushtruar të drejtën e vetos në vendimmarrje, sipas pikës 9 të këtij neni.

11. Kur Shoqëria bashkëpunon me subjekte të tjera, ndalohet tjetërsimi me shitje, ose përdorimi si garanci, kolateral, peng ose hipotekë, i pronave të paluajtshme shtetërore të kaluara në Shoqëri, me përjashtim të rasteve kur ka miratim të Këshillit të Ministrave, me qëllim garantimin e sigurisë juridike të këtyre pasurive.

12. Fondet e destinuara për prokurimin dhe furnizimin e institucioneve shëndetësore publike nuk përdoren për financimin e pjesëmarrjes në shoqëri të tjera ose për mbulimin e humbjeve të tyre.

Neni 7

Kalimi i pronave të paluajtshme shtetërore

1. Kur pronat e paluajtshme shtetërore janë me interes për zbatimin e projekteve të investimit, Shoqëria i propozon Këshillit të Ministrave, nëpërmjet ministrit përgjegjës për ekonominë dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë, kalimin e pronësisë, të përdorimit ose të çdo të drejte tjetër, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.

2. Këshilli i Ministrave përcakton mënyrat, kriteret dhe procedurat sipas të cilave Shoqëria ushtron të drejtat e saj mbi pronat e paluajtshme për zhvillimin e veprimtarisë së saj, përfshirë, por pa u kufizuar në dhënien për zhvillim, dhënien me qira ose përdorimin sipas formave të tjera të parashikuara në Kodin Civil dhe legjislacionin në fuqi.

3. Për zhvillimin e veprimtarisë së saj dhe me miratimin e Këshillit të Ministrave, Shoqëria mund të përdorë pronat e paluajtshme shtetërore si garanci, kolateral, peng ose hipotekë për marrjen e financimit, me qëllim rritjen e kapitalit, të aseteve ose të likuiditetit të nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë së saj.

Neni 8

Planifikimi vjetor

1. Çdo vit, Shoqëria harton planin vjetor të nevojave për produkte mjekësore për përdorim njerëzor, pajisje mjekësore, produkte të tjera shëndetësore dhe mallra e shërbime të tjera mbështetëse, të nevojshme për plotësimin e nevojave të institucioneve publike të kujdesit shëndetësor, bazuar në:

   a) nevojat dhe kërkesat e institucioneve publike të kujdesit shëndetësor;
   b) protokollet klinike dhe udhëzuesit terapeutikë;
   c) analizën e saj të konsumit, të stokut dhe të nevojave të sistemit shëndetësor publik, bazuar në parimet e efiçencës dhe të ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike;
   ç) analizën e tregut dhe sigurinë e furnizimit të vazhdueshëm;
   d) fondet e miratuara për financimin e shërbimeve shëndetësore.

2. Ministri përgjegjës për shëndetësinë miraton me urdhër rregullat e njësuara për hartimin e kërkesave për plotësimin e nevojave për produkte mjekësore për përdorim njerëzor, pajisje mjekësore, produkte të tjera shëndetësore dhe shërbime mbështetëse, afatet për paraqitjen e kërkesave në Shoqëri dhe formatin përkatës.

3. Bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, Asambleja miraton jo më vonë se më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik listën e produkteve mjekësore për përdorim njerëzor, pajisjeve mjekësore, produkteve të tjera shëndetësore dhe mallrave e shërbimeve të tjera mbështetëse.

Neni 9

Furnizimi i institucioneve publike të kujdesit shëndetësor

1. Për plotësimin e nevojave të institucioneve publike të kujdesit shëndetësor, Shoqëria ka të drejtë të organizojë, të kryejë ose të sigurojë blerjen, importin, magazinimin, transportin, shpërndarjen dhe furnizimin me produkte mjekësore për përdorim njerëzor, pajisje mjekësore dhe produkte të tjera shëndetësore, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi të zbatueshëm për produktet mjekësore, pajisjet mjekësore dhe produktet e tjera shëndetësore përkatëse.

2. Shoqëria siguron produkte mjekësore për përdorim njerëzor, pajisje mjekësore dhe produkte të tjera shëndetësore nga prodhues dhe furnizues vendas ose të huaj, nëpërmjet procedurave konkurruese, transparente dhe proporcionale, duke garantuar trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë dhe pa e kufizuar artificialisht konkurrencën.

3. Kur Shoqëria kryen drejtpërdrejt importin, tregtimin me shumicë, magazinimin, transportin ose shpërndarjen e produkteve mjekësore për përdorim njerëzor dhe pajisjeve mjekësore, ajo pajiset paraprakisht me licencat, autorizimet dhe certifikimet përkatëse, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi.

4. Kur importi, tregtimi ose transporti kryhet nga një subjekt tjetër, ky i fundit duhet të zotërojë të gjitha licencat, autorizimet dhe certifikimet e kërkuara sipas këtij ligji dhe legjislacionit të zbatueshëm. Barra dhe përgjegjësia për marrjen dhe ruajtjen e tyre i takojnë tërësisht këtij subjekti.

5. Kur justifikohet për arsye të mbrojtjes së shëndetit publik, për të garantuar vazhdimësinë e furnizimit dhe me autorizim për produktet mjekësore përkatëse, të lëshuar nga autoriteti kompetent për produktet mjekësore për përdorim njerëzor, Shoqëria mund të importojë produkte mjekësore nga një subjekt i autorizuar ligjërisht për furnizimin e tyre, me kusht që:

   a) produkti mjekësor zotëron autorizim të vlefshëm për tregtim si në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë, por importi i tij është i nevojshëm për shkak të një mungese të dokumentuar në tregun shqiptar; ose

   b) produkti mjekësor zotëron autorizim të vlefshëm për tregtim në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian dhe është identik ose mjaftueshëm i ngjashëm me një produkt mjekësor të autorizuar në Republikën e Shqipërisë; në këto raste zbatohen parimet që rregullojnë importin paralel; ose

   c) produkti mjekësor ka autorizim të vlefshëm për tregtim në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, por nuk ka autorizim për tregtim ose kërkesë në shqyrtim në Republikën e Shqipërisë; ose

   d) produkti mjekësor nuk është i autorizuar në Republikën e Shqipërisë ose në Bashkimin Evropian, por importi i tij është i nevojshëm për plotësimin e nevojave të veçanta terapeutike, të justifikuara ose për t'iu përgjigjur një emergjence të jashtëzakonshme të shëndetit publik.

6. Kushtet për dhënien e autorizimit të përmendur në këtë nen, paraqitja e kërkesave, procedura e shqyrtimit të tyre, si dhe kërkesat për verifikimin, etiketimin, gjurmueshmërinë, farmakovigjilencën dhe monitorimin e produkteve mjekësore, për të cilat jepet autorizimi, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Platforma elektronike

Shoqëria krijon dhe administron platformën dhe sistemet elektronike nëpërmjet të cilave kryen planifikimin, menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, administrimin e kontratave, monitorimin e stoqeve, gjurmueshmërinë e produkteve, shpërndarjen, menaxhimin dhe kontrollin e stoqeve, si dhe procese të tjera që lidhen me veprimtarinë e saj, duke garantuar sigurinë e informacionit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 11

Organet drejtuese

1. Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

   a) Asambleja e Përgjithshme;

   b) Këshilli Mbikëqyrës;

   c) Administratori.

2. Struktura dhe organika e Shoqërisë miratohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 12

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme vendos për:

a) miratimin e statutit të Shoqërisë dhe të ndryshimeve të tij;

b) miratimin e strategjisë së zhvillimit të Shoqërisë;

c) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të veprimtarisë;

ç) çështje të tjera të parashikuara nga ky ligj, ligji për shoqëritë tregtare dhe statuti i Shoqërisë.

Neni 13

Këshilli Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë:

   a) 2 (dy) anëtarë, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;

   b) 1 (një) anëtar, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për financat;

   c) 1 (një) anëtar, përfaqësues i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH);

   ç) 1 (një) anëtar, përfaqësues i Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM).

2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme, me propozimin e institucioneve përkatëse, të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës udhëhiqen nga parimi i mirëbesimit, përfshirë detyrimet e kujdesit, besnikërisë, konfidencialitetit, integritetit dhe pavarësisë në raport me Shoqërinë.

Neni 14

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës:

a) i propozon Asamblesë së Përgjithshme për miratim statutin dhe ndryshimet e tij;

b) propozon strategjinë e zhvillimit të Shoqërisë;

c) miraton planin e biznesit dhe planet vjetore të blerjeve;

ç) miraton projektet e investimeve dhe krijimin e strukturave të tjera;

d) kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave dhe të planeve të blerjeve;

dh) miraton treguesit e performancës;

e) siguron auditimin e Shoqërisë;

ë) përcakton pagat dhe shpërblimet e organeve drejtuese dhe të personelit;

f) kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 15

Administratori

1. Administratori është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë.
2. Administratori i jep llogari Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit Mbikëqyrës.
3. Administratori emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me kriteret e përcaktuara në statut.

Neni 16

Kompetencat e Administratorit

Administratori:

a) drejton veprimtarinë e Shoqërisë dhe siguron zbatimin e politikave të saj;

b) përfaqëson Shoqërinë në marrëdhëniet me palët e treta;

c) harton dhe nënshkruan bilancin vjetor dhe raportin e veprimtarisë;

ç) siguron respektimin e ligjit dhe të standardeve të kontabilitetit;

d) raporton në Këshillin Mbikëqyrës dhe në Asamblenë e Përgjithshme;

dh) kryen detyra të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 17

Personeli i Shoqërisë

1. Struktura dhe organika e Shoqërisë miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Marrëdhëniet e punës së personelit rregullohen nga Kodi i Punës dhe aktet e brendshme të Shoqërisë.

Neni 18

Kontrolli financiar

1. Shoqëria mban kontabilitetin e veprimtarisë së saj ekonomike në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
2. Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës hartojnë raportin e veprimtarisë, inventarët dhe llogaritë vjetore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Pasqyrat financiare të Shoqërisë auditohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për auditimin ligjor.

Neni 19
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 5, pikës 2, të nenit 7, si dhe pikës 6, të nenit 9, të këtij ligji, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për shëndetësinë për miratimin e aktit nënligjor në zbatim të pikës 2, të nenit 8, të këtij ligji, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 20
Dispozita të fundit

1. Për qëllime të këtij ligji, termi "produkte mjekësore për përdorim njerëzor" ka të njëjtin kuptim me termin "barna", sipas ligjit nr.105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", i ndryshuar.

2. Brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ministria përgjegjëse për shëndetësinë ndjek procedurat e nevojshme për:

    a. sigurimin e kapitalit të regjistruar;
    b. përzgjedhjen e anëtarëve të organeve drejtuese të Shoqërisë;
    c. miratimin e statutit të Shoqërisë;
    ç. regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

3. "MedAL" sh.a. njofton me shkrim institucionet publike të kujdesit shëndetësor për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë. Me marrjen e njoftimit, procedurat e prokurimit, që nuk janë publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, deri në momentin e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së "MedAL" sh.a., nuk i adresohen OBP sh.a.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

NIKO PELESHI